



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2018:048648

Datë: 08.04.2019

Numri i dokumentit: 00272061

**P.nr.108/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit Gani Rugova, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Drita Blakaj, në lëndën penale kundër të pandehurit, M. I., i akuzuar për veprat penale në bashkëveprim "Mundësim i arratisjes se personit te privuar nga liria nga neni 314 par.2 lidhur me nenin 23 KPK-së, dhe "Sulmit ndaj personit Zyrtar gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 23 KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje, Departamenti i Përgjithshëm, më PP/II nr.810/13 dt. 02.04.2014, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.05.04.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Lumturie Hoxha, dhe të pandehurit, M. I. me av.mbrojtës Shaban Jahaj i caktuar sipas detyrës zyrtare, Gjykata me dt.08.04.2019 publikisht mori dhe shpalli, dhe bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**1. PJESA REFUZUESE**

**1.M. I.** i lindur me dt. ...., në.... Republika e Maqedonisë i biri i B. dhe nënës Z. e vajzërisë E., me nr. personal ...., i martuar, babai i 4 (fëmijëve) ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, i pa dënuar më parë nga ana e gjykatës së RKS, gjendet në liri.

Në kuptim të nenin 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

**REFUZOHET DISPOZITIVI I II I AKTAKUZES**

## **Gjëja se: I pandehuri M. I.**

**II.** Me datë 18.08.2007, rreth orës 16:20 në Pavionin numër 1. Të Burgut të Dubravës K.Istog në bashkëveprim i kanë sulmuar personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, në atë mënyrë që ditën kritike duke iu mundësuar arratisjen e të burgosurve F. H. , B. B. , R. SH., L. J., XH. M., A. Sh. dhe A.S. të cilët në bazë të ligjit kanë qenë të privuar nga liria, ashtu që në momentin e kur të njëjtit kanë kaluar murin e burgut, të pandehurit M. dhe B. së bashku me të pandehurin I. S., S. I., O. K. , G. SH. dhe B. L. të gjithë kanë shtënë me armë të llojeve të ndryshme, granata dore, minahedhës dhe municion, duke shtënë në drejtim të policisë së UNMIK-ut, njësitit polak, të cilët kanë qenë në sigurimin e jashtëm të burgut, e me qëllim që tu mundësohet arratisja më e lehtë e të burgosurve si dhe të pamundësohet kapja e tyre,

- me çka në bashkëveprim kishte për të kryer vepër penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së

Për shkak të heqjes dorë të Prokurores së Shtetit nga Aktakuza, për arsye se për këtë vepër penale ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale sipas dispozitave të kodit penal nga neni 106 par.1 lidhur me pikën 1.4 dhe nenit 107 par.8 të KPK-së .

Shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të kësaj gjykate në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

## **2. PJESA DËNUESE**

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

**I.** Me dt.18.08.2017 rreth orës 16:20 nga Pavioni nr.1 i Burgut të Dubravës K.Istog, në bashkëveprim ua kanë mundësuar arratisjen e të burgosurve F. H. , B. B. , R. SH., L. J., XH. M., A. Sh. dhe A. S. të cilët në bazë të ligjit kanë privuar nga liria, në atë mënyrë që sipas një plani të përgatitur më parë, ditën kritike rreth orës 12:30 të pandehurit M. dhe B. janë takuar me të pandehurit S. I., O. K. , G. SH. dhe B. L. te restoranti “P...” ku aty kanë hartuar planin e veprimit e pastaj me tri automjete udhëtarësh dhe me armë të ndryshme si pushkë automatike të llojeve të ndryshme, granata dore, minahedhës dhe municion, e të fshehura në bagazhin e automjeteve janë afruar te Burgu i Dubravës në një largësi prej 300 metrash ku i kanë ndaluar automjetet, e pastaj nga bagazhi kanë nxjerrë armët dhe janë fshehur pas disa shkurreve, ashtu që në çastin kur të burgosurit kanë kaluar murin e burgut, të pandehurit të dy së bashku edhe me të tjerët kanë shtënë disa herë me armë në drejtim të burgut, e ku me këtë veprim ua kanë mundësuar arratisjen më të lehtë dhe pa pengesa të burgosurve të lartcekur, e pas kësaj me të shpejtë të gjithë së bashku kanë ikur në drejtim të panjohur

-me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria nga neni 314 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,43,45,49,50,51,73,74 dhe nenit 314 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366,450,463 të KPPRK, të pandehurit i shqipton.

## DËNIM ME KUSHT

1. Ashtu Gjykata të pandehurit **M. I.** i përcakton dënimin me burg, në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej **2 (dy) vite** nuk kryen ndonjë vepër të re penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 453 par 4 të KPPK-së, e ka liruar në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale, dhe paushalli gjyqësore, për shkak të kushteve të renda ekonomiko familjare.

3. Të dëmtuarit – dëshmitarët T.SH., M. K. dhe K.L. , të tre ish policë të UNMIK-ut, për realizimin e dëmit të shkaktuar nga i pandehuri udhëzohen në kontest të rregullt civil-juridik.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate, ka ngrit aktakuzën me PP/II.nr.810/13 të dt.02.04.2014 ndaj të pandehurve, M. I. dhe B.A. Republika e Maqedonisë, të akuzuar si bashkëkryerës për veprat penale, “Mundësimi i Arratisjes së Personit nga Liria” nga neni 314 par.2 dhe “ Sulmi ndaj Personit Zyrtar gjatë kryerjes së detyrave Zyrtare” nga neni 317 par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Në këtë çështje juridiko-penale me datë 19.06.2017 është caktuar shqyrtimi fillestar ka prezentuar prokurori i shtetit ,nuk ka prezentuar i pandehuri M.I. me çka gjykata ka kërkuar informacion shtesë lidhur me vendqëndrimin me çka ka marrë informacion se të njëjtit janë ekstraduar ne Republikën e Maqedonisë me çka përmes Ministrisë së drejtësisë –ndihmës juridike gjykata është munduar ti njoftojë me ftesa mirëpo në pamundësi të sigurimit të prezencës së tyre, gjykata ka lëshuar Letër rreshtim.

Ndersa me dt.13.03.2019, është mbajtur seanca fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Lumturie Hoxha dhe të pandehurit M. I. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Shaban Jahaj, për të cilin është lëshuar urdhëresë për shpallje të letër-rreshtimit me dt.28.06.2017, mirëpo i njëjti me dt.12.03.2019 është arrestuar nga ana e policisë së Kosovës sipas urdhërarrestit dhe me dt.13.03.2019 është sjellë në gjykatë, nuk ka prezantuar B.A. , për të cilin është lëshuar urdhëresë për shpalljen e letër-rreshtimit dhe ndaj tij gjykata pas marrjes së mendimit të palëve të cilët nuk kundërshtuan, ka marrë aktvendim për veçimin e procedurës dhe lënda do të marrë numër të ri.

Para leximit të aktakuzës prokurorja e shtetit deklaroi se: sa i përket veprës të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, kam vërejtur se për këtë vepër penale ka arritur afati i parashkrimit absolut i ndjekjes penale sipas dispozitave të kodit penal nga neni 106 par.1 lidhur me pikën 1.4 dhe nenit 107 par.8 të KPK-së, andaj si prokuror e shtetit heqi dorë nga dispozitivi i dytë i aktakuzës ndërsa gjykata vazhdon procedurën me leximin e aktakuzës së dispozitivit të parë, ndërsa për heqje dorë gjykata ka pruar aktgjykim refuzues sa i përket dispozitivit të dytë të aktakuzës.

Gjatë kësaj seance, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores, të pandehurit iu dha mundësia të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij, i pandehuri në konsultim me mbrojtësin e tij u deklarua se nuk e pranon fajësinë lidhur me veprën penale me të cilën akuzohet, ndërsa në këtë shqyrtim fillestar i pandehuri ka heq dorë nga kundërshtimi i aktakuzës dhe provave për të vazhduar me shqyrtimin gjyqësor. Gjykata merr dhe pëlqimin e palëve tjera për të shkuar në shqyrtimin gjyqësor, ku do të ftohen dhe dëshmitarët.

Gjykata ka mbajtur seancën gjyqësore më datë 05.04.2019, ku kanë marrë pjesë, Prokurori i Shtetit, Lumturie Hoxha, i pandehuri M. I. me mbrojtësin e tij Av. Shaban Jahaj i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe dëshmitarët N. H. dhe B. Z. .

Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të pandehurit iu ofrohet mundësia edhe njëherë të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë e tij.

I pandehuri **M. I.** në konsultim me mbrojtësin e tij deklaron: se e pranon fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë për dispozitivin e parë të aktakuzës dhe më vije keq kjo që ka ndodhur dhe shprehë keqardhje dhe premtojë gjykatës që kjo nuk do të përsëritet më kurrë e as që do të kryej ndonjë vepër penale.

Av. Shaban Jahaj në fjalën e tij deklaron: Pas konsultimit me të mbrojturin tim, ku jam kam shpjeguar mirë nocionin mbi pranimin apo mos pranimin e fajësisë, për pasojat dhe përparësitë dhe i njëjti është dakorduar dhe pasi që ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e kësaj vepre penale, ka vendosur të shkojë me pranim fajësie, andaj unë si mbrojtës i tij, kërkojë që gjykata të mbrojturit tim të i shqiptojë një dënim më të butë, për shkak se është i vetmi mbajtës i familjes, si dhe i gjendjes jo të mirë ekonomike.

Pas deklarimit të të pandehurit gjykata kërkojë mendimin e prokurorit e cila deklaroj se pajtohet me pranimin e fajësisë për të pandehurin ,i cili pranim është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës .

Pas deklarimit të të pandehurit dhe dëgjimin e mendimit të prokurores, Gjykata konstatoj se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur, andaj gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pasur parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1, pika 1.1, 1.2, 1.3, të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par.4, të KPRK-së, atëherë me këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve në kuptim të nenit 352 të KPPRK-së.

### **Fjala përfundimtare e fjalëve:**

**Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron:** meqenëse i akuzuari e pranon fajësinë të cilën e konsiderojmë që është në përputhshmëri me dispozitivin e aktakuzës e mbështetur ne prova të propozuara gjykatës për administrim, propozoj gjykatës që te akuzuarin ta shpallë fajtor, për veprën penale e cila i bje në barrë, dhe te dënoj sipas ligjit, njëkohësisht i propozojë gjykatës se gjatë marrjes se vendimit ne këtë çështje juridiko-penale te merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë si dhe gjendjen ekonomike e te akuzuarit.

Av. Shaban Jahaj në fjalën përfundimtare deklaron pas pranimit të fajësisë e të mbrojturit tim i propozojë gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të shqiptohet një masë më e butë, gjegjësisht alternative konform nenit 41 pika 1 të KPK-së ngase mendoj që me një shqiptim të masës më të butë do të ndikoj pozitivisht në të mbrojturin tim dhe risocializimin e tij duke shpresuar që nuk do të përsërit në të ardhmen vepra të njëjta apo të ngjashme penale. Me çka do të arrihet qëllimi i ndëshkimit. Si dhe nga gjykata pas marrjes së vendimit mbi shpalljen kërkohet që të mbrojturit tim të ndërpritet paraburgimi.

**I pandehuri M. I., në fjalën përfundimtare deklaroj:** Pajtohem me deklaratën e mbrojtësit tim, vetëm se dua të shtojë, se pasi që tani kam krijuar familje në Kosovë, dhe pasi që kam 4 fëmijë të vogël, i kam dhënë vetes detyrë që gjithmonë ta respektoj ligjin dhe mos të bie ndesh me të. Si dhe i premtoj gjykatës që nuk do përsërisë më ndonjë veprë penale.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, padyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit M. I., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria nga neni 314 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin M. I., gjykata ka gjetur se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer, premtimin se nuk do të përsëris më veprë penale, të ardhura siguron nga puna si punëtor në hoteleri, jeton në bashkësinë familjare 6 anëtarësh, ka gjendje jo të mirë ekonomike, Rrethana rënduese gjykata gjeti se i pandehuri ka qenë i dënuar dhe më parë për veprë penale në shtetin e Maqedonisë.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana në kuptim të nenit 73,74 të KPRK-së të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPK-së.

Duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurin e ka liruar nga shpenzimet procedurale për shkak se pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose personave që detyrohet të mbështesë materialisht.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil është marrë konform nenit 463 par. 1. dhe 2. të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA ISTOG  
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL  
P.nr.108/14 më datë 05.04.2019**

**Sekretarja Juridike**

---

**Drita Blakaj**

**Gjyqtari Gjykues**

---

**Gani Rugova**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate